



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PROCESVERBAL

Mbledhja parë e komitetit për Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur më datë 06.03.2025 (e enjte), me fillim në ora 11:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **znj. Almedina Jaha**. Shumica e anëtarëve të komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Zgjedhja e kryesuesit të ri të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara;
3. Diskutimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e parë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Zgjedhja e kryesuesit të ri të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara:

Kryesuesja: Pikën e dytë e heqim nga rendi i ditës, sepse kryesuesi i ri do të zgjedhet në mbledhjen e ardhshme.

3. Diskutimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka diçka për të shtuar sa i përket planit të punës?...

Atdhe Rama: Faleminderit! Plani i punës është mjaft i mirë. Shpresoj që të zbatohet në plotni dhe prej mbledhjes së ardhshme, këtë plan do ta kenë edhe anëtarët e rinj të këtij komiteti, meqë Altina dhe Almedina po largohet, sepse janë punësuar.

Kryesuesja: Faleminderit Atdhe! Nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë për të shtuar, planin e punës e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Unanimisht votohet plani i punës për vitin 2025.

4. Të ndryshme:

Atdhe Rama: Kam dëshirë ta falënderoj kryesuesen që ka qenë pjesë e këtij komiteti. E falënderoj për kontributin e madh të saj dhe i dëshiroj shëndet e suksese në punën e re.

Selman Shtavica: Gjithashtu edhe unë i bashkëngjitëm urimit të Atdheut.

Kryesuesja: Ju falënderoj shumë të gjithëve! Atëherë, po e shpalli të përfunduar takimin e parë. Ju dëshiroj suksese tutje.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi



Kryesuesja e komitetit

Almedina Jaha